

UDHËZIM
Nr. 3, datë 19.1.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË
4.9.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe një shtesë, si më poshtë:

1. Në pikën 2.3, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

a) në shembullin e 4-të, paragrafi me përmbajtje: “Nga shuma mujore e arkëtimeve nga TVMP-ja, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të arkëtimeve, 25 (njëzet e pesë)% e diferencës (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) së arkëtimeve e derdhin në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Pjesa tjetër e mbetur prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) % (75% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) paguhet për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar DPSHTRR-ja (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës”, zëvendësohet me paragrafin me përmbajtje si vijon:

“Nga shuma mujore e arkëtimeve nga TVMP-ja, DPSHTRR-ja, pasi mban komisionin në masën 5 (pesë) % të totalit mujor të arkëtimeve, derdh diferencën e mbetur prej 95 (nëntëdhjetë e pesë) % në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), brenda datës 15 të muajit pasardhës.

DPSHTRR-ja i dërgon Ministrisë së Financave informacion mbi vlerën takuese për t’u shpërndarë sipas njësive të vetëqeverisjes vendore (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja), brenda datës 15 të muajit pasardhës.

Ministria e Financave do t’i dërgojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerën takuese për t’u shpërndarë sipas bashkive. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve transferon vlerën takuese të të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe pjesa tjetër mbetet në buxhetin e shtetit.”;

b) në paragrafin e fundit, fjalja me përmbajtje: “DPSHTRR-ja llogarit dhe transferon për llogari të njësive të qeverisjes vendore shumën e të ardhurave që ju takojnë këtyre njësive nga taksa e mbledhur, si dhe deklarojnë dhe paguajnë në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që ata përfitojnë, si dhe vlera e transferuar te njësitë e qeverisjes vendore.”, zëvendësohet me fjalinë me përmbajtje si vijon:

“DPSHTRR-ja llogarit dhe transferon në llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve shumën e të ardhurave nga taksa e mbledhur prej 95%, pasi zbresin vlerën e komisionit prej 5% që ata përfitojnë.”.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “b.1”, e pikës 3.1, ndryshohet si më poshtë:

“b.1 pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara ose të lëna në ruajtje me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ose dokumentacioni i mjetit ka qenë i bllokuar dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.”;

b) shkronja “c”, e pikës 3.4 ndryshohet si më poshtë:

“c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara ose të lëna në ruajtje me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ose dokumentacioni i mjetit ka qenë i bllokuar dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj